


050/26
10.02.2026



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të rregullt, e mbajtur më datën 10.02.2026, merr këtë:

VENDIM NR.01/2026/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 30.12.2025

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 30.12.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 30.12.2025.


Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milani Dimitrijević





PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 30.12.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë 19 asamblistë dhe ka kuorum. Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesit e KFOR-it, mediat, qytetarët, drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 është caktuar rendi i mëposhtim i ditës:

1. Dhënia e betimit nga asamblistët e sapoemëruar të Kuvendit të komunës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja konstituive, e mbajtur më datën 05.12.2025.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
5. Konstituimi i Komitetit për Politikë dhe Financa.
6. Konstituimi i Komitetit për Komunitete.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronës së paluajtshme të komunës të destinuar për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Dhënia e betimit nga asamblistët e sapoemëruar të Kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit shpjegoi se kryetari i Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq, kishte dhënë dorëheqje nga posti i tij si asamblist dhe se Dijana Zhiviq ishte emëruar në vend të tij,

ndërsa Nikolla Rashiq është asamblisti i ri në vend të Igor Rashiqit, i cili gjithashtu kishte dhënë dorëheqje. Kryesuesi i ftoi asamblistët e sapoemëruar ta lexonin tekstin e deklaratës solemne dhe ta nënshkruanin atë.

„Unë, Dijana Zhiviq, Nikolla Rashiq, deklaroj solemnisht që do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja konstituive, e mbajtur më datën 05.12.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).

Kryesuesi tha se neni 61 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 përcakton që në komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë, ai komunitet do të ketë një nënkryetar të komunës për komunitete, i cili do të propozohet nga kryetari i Komunës jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së postit të lirë. Në pajtim me Grupin e asamblistëve “Aleanca Shqiptare”, kryetari i Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq, e propozoi asamblistin Leutrim Ajeti.

Asamblisti i KK të Graçanicës, Leutrim Ajeti, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha: “I falënderoj të gjithë qytetarët që ma dhanë këtë pozitë në të cilin ndodhem tani, gjithashtu e falënderoj kryetarin e komunës, Novak Zhiviq dhe kryesuesin e Kuvendit, Millan Dimitrijeviq për besimin që më kanë treguar”.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).

Kryesuesi tha se neni 54 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 përcakton se në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendëskryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Në pajtim me Grupin e asamblistëve “Aleanca Shqiptare”, për këtë post është propozuar Bekim Gashi.

Asambleti i KK të Graçanicës, Bekim Gashi, para partisë “Aleanca Shqiptare” tha: “I falënderoj të gjithë qytetarët dhe premtoj se do të punoj për të mirën e tyre”.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblestëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Konstituimi i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi tha se neni 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 përcakton se Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteve politike në Kuvendin e komunës. Në marrëveshje me të gjitha partitë, është propozuar që Komiteti i Politikës dhe Financave të ketë këtë përbërje:

1. Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*), SRPSKA LISTA, kryesues,
2. Ljubisha Karaxhiq (*Ljubiša Karadžić*), SRPSKA LISTA, anëtar,
3. Millosh Dimiq (*Miloš Dimić*), SRPSKA LISTA, anëtar,
4. Aida Qerkini, ALEANCA SHQIPTARE, anëtare,
5. Ivana Vujoviq (*Ivana Vujović*), ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK, anëtare.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblestëve “Pro”, miratoi pikën e pesë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Konstituimi i Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi tha se neni 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 përcakton që anëtarësia e Komitetit të Komuniteteve të përbëhet nga asamblestët e Kuvendit të komunës dhe komunitetet pakicë të përfaqësuar në territorin e Komunës së Graçanicës. Komunitetet pakicë kanë paraqitur kërkesë në Kuvendin e komunës me nënshkrimet e qytetarëve dhe propozimi është që Komiteti i Komuniteteve të përbëhet si në vijim:

1. Turkijan Tairi, përfaqësues i komunitetit rom,
2. Enes Sopjani, përfaqësues i komunitetit shqiptar,
3. Mersiha Bajrami, përfaqësuese e komunitetit goran,
4. Aziz Karadollami, përfaqësues i komunitetit boshnjak,
5. Florim Bajrami, përfaqësues i komunitetit ashkali,
6. Bojana Mitiq (*Bojana Mitić*), asambleste e KK të Graçanicës,
7. Bobana Jovanoviq Trajkoviq (*Bobana Jovanović Trajković*), asambleste e KK të Graçanicës,
8. Lumnije Gashi, asambleste e KK të Graçanicës,

9. Nikolla Rashiq (*Nikola Rašić*), asamblist i KK të Graçanicës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronës së paluajtshme të komunës të destinuar për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, shpjegoi se nevojitet një vendim nga Kuvendi i komunës, në mënyrë që prona e paluajtshme komunale të vihet në shfrytëzim në vitin 2026. “Keni një pjesë të parcelës në Llapllasellë, siç mund të shihni, pastaj parcelat në Graçanicë për ndërtimin e një impianti për prodhimin e energjisë elektrike dhe energjisë diellore, pra panele diellore, pastaj parcela në Llapllasellë që është ndarë për ndërtimin e Stacionit të zjarrfikësve. Pastaj, ka parcela të vendosura në zonën afariste në Gushtericën e Poshtme, sipas Planit të përcaktuar Zhvillimor të Komunës së Graçanicës, si dhe parcelat përballë Shkollës fillore “Milladin Mitiq” në Llapllasellë, parcelat në Suhadoll, ku ka tre dyqane në Suhadoll, pra të cilat tashmë janë në ndërtesa banimi, dy dyqane në Lepinë, dyqane në Llapllasellë dhe parcela në të cilën ndodhen këto dyqane, dyqane në Qendrën tregtare Graçanicë dhe dyqane në Gushtericën e Poshtme”, tha drejtoresha Gjekiq, duke shpjeguar propozimin.


Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 19 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Të ndryshme.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 10:17.

Procesmbajtësi
Agron Karadollami





Kryesuesi i KK të Graçanicës



Milan Dimitrijević